

C.nr.319/16

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil me gjyqtari Alban Beqiri, me sekretaren juridike Lendita Pajaziti, në çështjen juridike të paditësit [REDAKTUAR] nga Ferizaj, [REDAKTUAR] kundër të paditurit [REDAKTUAR] nga Ferizaj [REDAKTUAR], për çështjen juridike, borxh, vlera e kontestit 1.000 €, pas seancës publike të mbajtur më 21.09.2017, në prezencën e paditësit dhe në mungesë të paditurit mori këtë:

AKT GJYKIM

I. APROVOHET në tërësi kërkesë padia e paditësit [REDAKTUAR] nga Ferizaj, [REDAKTUAR] si e bazuar.

II. DETYROHET i padituri, që paditësit t'i paguajnë borxhin në shumën prej 1.000 € (një mijë) euro, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 30 €, të gjitha në afat prej 15 dite, pas marrjes së formës së prerë të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Arsyetim

Paditësi në fjalën e tij ka deklaruar, mbesë në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, thëniet e cekura në të, duke shtuar se sa i përket kontratës mbi huanë të dt.31.08.2015, e lidhur tek avokati [REDAKTUAR] në shumë prej 1.000 euro, kjo kontratë është lidhur si rezultat pasi që të paditurit ia kam shitë veturën BMW të tipit 316 viti i prodhimit 92, në shumë prej 1.000 euro, të cilën shumë i njëjti ka pasur për obligim ta përmbush deri më dt.15.09.2015, e të cilën pagesë i padituri nuk e ka përmbushur.

I ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia të aprovohet në tërësi si a bazuar, dhe të detyrohet i padituri, paditësit t'ia përmbush obligimin në emër të borxhit shumë e precizuar.

I ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Gjykata seancën gjyqësore e ka mbajtur në mungesë të paditurit në bazë të nenit 409.2 të LPK-së, pasi që i njëjti e ka pranuar ftesën në mënyrë të rregullte, siç shihet nga fletëkthesa e ardhur e dt.08.09.2017, në seancë nuk ka prezantuar dhe mungesën nuk e kanë arsyetuar.

Gjykata në këtë çështje bëri administrimin e provave duke bërë leximin e tyre: U lexua padia e paditësit C.nr. 319/16 dt.31.03.2015, Kontrata mbi huanë e dt.31.08.2015 e përpiluar tek avokati [REDAKTUAR] e nënshkruar nga palët kontraktuese.

Gjykata pas vlerësimit të provave të administruara një nga një dhe të gjitha sbashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së gjeti se kërkesë padia e paditëses është e bazuar.

Nga provat e administruara u vërtetua se palët ndërgjygjëse kanë lidhur kontratë për shitblerjen e automjetit BMW të tipit 316 viti i prodhimit 1992, në vlerë prej 1.000€, të cilën shumë i padituri ka qenë i obliguar ta paguaj deri më dt.15.09.2015 e nga e cila provë vërtetohet se i padituri me paditësin janë në raport juridiko-civil ndërmjet vete sipas nenit 26 LMD-së dhe nga ky raport janë krijuar të drejtat dhe detyrimet në kuptim të nenit 148 lidhur me nenin 583 të LMD-së, i cili fakt vërtetohet nga provat e administruara dhe atë nga kontrata mbi huan e dt.31.08.2015 e përpiluar tek avokati [REDACTED] e nënshkruar nga palët kontraktuese.

Meqenëse i padituri nuk është paraqitur në gjykatë, gjykata është kujdesur që sipas detyrës zyrtare se mos po iu cenohen të drejtat dhe detyrimet e të paditurit në këtë çështje kontestimore, ku pas administrimit të provave ka konstatuar se i padituri nuk e kanë përmbushur detyrimin ndaj paditësit, andaj edhe kanë vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e mbështeti në nën.452.1 të LPK-së në të cilat shpenzime është llogaritur taksa gjyqësore për padi prej,15 € dhe aktgjykim prej, 15€, gjithsej në lartësi prej 30 €.

Nga sa u tha më lart u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.319/16 më dt.21.09.2017

Gjyqtari
Alban Beqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROSEVAC

10. 10. 2017